



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10

Prokurori kundër Sabit Januzit dhe Ismet Bahtijarit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 31 tetor 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Urdhër në lidhje me (Ri)klasifikimin e Parashtrimeve të Protokolluara

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtësit Kujdestar të Sabit Januzit

Tomas Gillis

Mbrojtësit Kujdestar të Ismet Bahtijarit

Hendrik Sitema

Administratores

Fidelma Donlon

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të neneve 21(2) dhe (6), 23(1) dhe 39(6) dhe (11) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 80(1) dhe 82(5) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 2 tetor 2023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi Aktakuzën kundër Sabit Januzit dhe Ismet Bahtjarit² ("z. Januzi", "z. Bahtjari", së bashku, "të akuzuarit", "Vendimi i Konfirmimit").³
2. Më 9 tetor 2023, pas arrestimit dhe transferimit nga Kosova,⁴ të akuzuarit u paraqitën para Gjykatësit të Procedurës Paraprake.⁵
3. Më 17 tetor 2023, Gjykatësi i Vetëm, përgjegjës për temat në kuadrin e çështjes KSC-BC-2018-01, urdhëroi kalimin e parashtrimeve të protokolluara dhe

¹ KSC-BC-2023-10, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 11 shtator 2023, publik.

² Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka marrë shënim se mënyra e saktë e shkrimit të mbiemrit të të akuzuarit është "Bahtjari" (shih KSC-BC-2023-10, F00080, Administratorja, *Njoftim i Dokumentit të Identitetit*, 26 tetor 2023, konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, konfidenciale dhe *ex parte*).

³ KSC-BC-2023-10, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 2 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik i vendimit u dorëzuan më 12 tetor 2023, F00008/CONF/RED dhe [F00008/RED/COR](#).

⁴ KSC-BC-2023-10, F00011, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Ismet Bahtjarit sipas Rregullës 55(4)*, 5 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00012, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Sabit Januzit sipas Rregullës 55(4)*, 5 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00014, Administratorja, *Njoftim i Pranimit të Ismet Bahtjarit në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 6 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00015, Administratorja, *Njoftim i Pranimit të Sabit Januzit në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 6 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁵ KSC-BC-2023-10, [Transcript of Hearing](#) (Transkripti i seancës), 9 tetor 2023, publik, f. 1-16; [Transcript of Hearing](#) (Transkripti i seancës, 9 tetor 2023, publik, f. 17-32. Shih gjithashtu F00017, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë të Sabit Januzit dhe Ismet Bahtjarit dhe Çështje të lidhura me Të*, 6 tetor 2023, publik, para. 21(a)-(b).

vendimeve përkatëse nga dosja gjyqësore KSC-BC-2018-01 në dosjen gjyqësore të kësaj çështjeje.⁶

II. DISPOZITAT LIGJORE PÛRKATËSE

4. Në bazë të nenit 21(2) të Ligjit, në përcaktimin e akuzave kundër tij, i akuzuari gëzon të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik, në pajtim me nenin 23 të Ligjit dhe rregullën 80(1) të Rregullores dhe çdo masë të urdhëruar nga Dhomat e Specializuara ("DHS") për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve.

5. Në bazë të nenit 21(6) të Ligjit, i gjithë materiali dhe provat ose faktet relevante në zotërim të Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS") që janë në favor ose kundër të akuzuarit, i vihen në dispozicion të akuzuarit para fillimit të procesit dhe gjatë procesit, vetëm me kufizime rreptësisht të domosdoshme dhe me zbatimin e garancive mbrojtëse kompensuese të nevojshme.

6. Në bazë të rregullës 82(5) të Rregullores, kur arsyet për riklasifikim pushojnë së ekzistuari, dorëzuesi i parashtrimit të protokolluar të parë i paraqet kërkesë panelit për riklasifikim. Gjithashtu, paneli mund ta riklasifikojë statusin e një parashtrimi të protokolluar me kërkesë të një pjesëmarrësi tjetër në proces apo *proprio motu*.

III. DISKUTIM

7. Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të nevojshme t'u vërë në dispozicion z. Januzi dhe z. Bahtijari parashtrime të protokolluara dhe vendime relevante, përfshirë ato që janë lëshuar përpara Vendimit të Konfirmimit në lidhje me ta, për shkak se mund të jenë thelbësore për përgatitjen e mbrojtjes së tyre.

⁶ KSC-BC-2018-01, F00482, Gjykatësi i Vetëm, *Urdhër për Transferimin e Dokumenteve*, 17 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Në vijim, ky parashtrim i protokolluar u përfshi edhe në këtë dosje gjyqësore (shih KSC-BC-2023-10, F00037).

8. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kushton vëmendje, nga njëra anë, parimit të procesit publik, sikurse përcaktohen në nenet 21(2) dhe 39(6) të Ligjit, i cili vlen jo vetëm për seancat në sallën e gjyqit, por edhe për parashtrimet e protokolluara dhe çdo material tjetër në dosjen e çështjes,⁷ dhe, nga ana tjetër, detyrës së Gjykatësit të Procedurës Paraprake për të siguruar mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave dhe të informacionit konfidencial, në përputhje me nenin 23(1) të Ligjit dhe rregullën 80(1) të Rregullores.

9. Bazuar në sa më lart, **ZPS-ja** urdhërohet të bëjë të ditur nëse parashtrimet e protokolluara në vijim mund të riklasifikohen si publike dhe/ose konfidenciale, dhe të hiqet shënimi *ex parte*, sipas rastit:

- F0004 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*);
- F00013 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*);
- F00023 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*);
- F00024 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*);
- F00036 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*);
- F00038, F00038/A01, F00038/A02, F00038/A03 (aktualisht të klasifikuar si rreptësisht konfidencialë dhe *ex parte*);

⁷ Shih KSC-BC-2020-04, F00277, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Urdhër për Parashtrime në lidhje me Riklasifikimin e Parashtrimeve të Protokolluara ose të Versioneve të Redaktuara, 17 qershor 2021, publik, para. 5; KSC-2020-07, F00115, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Urdhër për Riklasifikimin e Parashtrimeve të Protokolluara, 4 shkurt 2021, publik, para. 6.

- F00039 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*);
- F00040 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*);
- F00042, F00042/A01 (aktualisht të klasifikuar si rreptësisht konfidencialë dhe *ex parte*);
- F00044 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*);
- F00046 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*);
- F00047, F00047/A01, F00047/A02 (aktualisht të klasifikuar si rreptësisht konfidencialë dhe *ex parte*);
- F00049, F00049/A01, F00049/A02, F00049/A03, F00049/A04 (aktualisht të klasifikuar si rreptësisht konfidencialë dhe *ex parte*);
- F00050 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*);
- F00052, F00052/A01 (aktualisht të klasifikuar si rreptësisht konfidencialë dhe *ex parte*);
- F00053 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*);
- F00054 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*);
- F00057, F00057/A01 (aktualisht të klasifikuar si rreptësisht konfidencialë dhe *ex parte*);

- F00058 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*);
- F00059 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*);
- F00060 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*);
- F00061 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*);
- F00065, F00065/A01 (aktualisht të klasifikuar si rreptësisht konfidencialë dhe *ex parte*);
- F00068 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*);
- F00070 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*); dhe
- F00071, F00071/A01, F00071/A02 (aktualisht të klasifikuar si rreptësisht konfidencialë dhe *ex parte*).

10. **Mbrojtja e z. Bahtijari** urdhërohet të bëjë të ditur nëse parashtimi i protokolluar F00073 (aktualisht i klasifikuar si konfidencial) mund të riklasifikohet si publik.

11. Gjithashtu, **Administratorja** urdhërohet të bëjë të ditur nëse parashtimet e protokolluara në vijim mund të riklasifikohen si publike dhe/ose konfidenciale dhe të hiqet shënimi *ex parte*, sipas rastit:

- F00011 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*);

- F00012 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*);
- F00014, F00014/A01 (aktualisht të klasifikuar si rreptësisht konfidencialë dhe *ex parte*);
- F00015, F00015/A01 (aktualisht të klasifikuar si rreptësisht konfidencialë dhe *ex parte*);
- F00018 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*);
- F00019 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*);
- F00020/A01, F00020/A02, F00020/A03 (aktualisht të klasifikuar si rreptësisht konfidencialë dhe *ex parte*);
- F00021/A01, F00021/A02, F00021/A03 (aktualisht të klasifikuar si rreptësisht konfidencialë dhe *ex parte*); dhe
- F00066 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*).

12. Në rast se ZPS-ja, Mbrojtja e z. Bahtijari, ose Administratorja dëshirojnë të ruajnë klasifikimin aktual për një apo për të gjitha parashtrimet e protokolluara të lartpërmendura, duhet: (i) të specifikojnë arsyet për ruajtjen e klasifikimit aktual, në përputhje me rregullën 82(3) të Rregullores, si dhe të tregojnë nëse dhe kur mund të ndryshohet statusi i klasifikimit përkatës; dhe (ii) të dorëzojnë versionin ose versionet publike dhe/ose konfidenciale të tyre, sipas rastit.

13. Gjithashtu, **Administratorja** urdhërohet të riklasifikojë si konfidenciale, si edhe të heqë shënimin *ex parte* të parashtrimeve të protokolluara në vijim:

- F00009 (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*), F00009/A01, F00009/A02, F00009/A03 (aktualisht të klasifikuar si rreptësisht konfidencialë);

14. **Administratorja** urdhërohet të riklasifikojë si konfidencial, si edhe të heqë shënimin *ex parte* dhe të dorëzojë versionet e redaktuara publike të parashtrimeve në vijim:

- F00020/COR (pa shtojcat) (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*); dhe
- F00021 (pa shtojcat) (aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*).

15. Së fundi, **Administratorja** urdhërohet të riklasifikojë si publik parashtrimin e protokolluar F00027 (aktualisht i klasifikuar si konfidencial).

16. Gjykatësi i Procedurës Paraprake informon palët se versionet e redaktuara publike dhe/ose konfidenciale të vendimeve në dosjen e çështjes do të përgatiten pas parashtrimit të kërkuar në këtë urdhër.

IV. VENDIM

17. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **URDHËRON** ZPS-në, Mbrojtjen e z. Bahtijari dhe Administratoren të bëjnë të ditur **deri të hënën, 6 nëntor 2023**, nëse parashtrimet e protokolluara të renditura në paragrafët 9-11 të këtij urdhri, mund të riklasifikohen si publike dhe/ose konfidenciale, dhe të hiqet shënimi *ex parte*, sipas rastit, ose të

parashtrojnë arsyet për ruajtjen e klasifikimit dhe të parashtrojnë versionin apo versionet e redaktuara konfidenciale të tyre **deri të hënën, 13 nëntor 2023** dhe versionin apo versionet e redaktuara publike të tyre **deri të hënën, 27 nëntor 2023**; dhe

- b) **URDHËRON** Administratoren të riklasifikojë si konfidenciale parashtrimet e protokolluara të renditura në paragrafët 13-15 të këtij vendimi dhe **deri të hënën, 13 nëntor 2023**, të parashtrojë versionet e redaktuara publike të parashtrimeve të protokolluara të renditura në paragrafin 14 të këtij urdhri.

_____/nënshkrimi/____

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i Procedurës Paraprake

E martë, 31 tetor 2023

Në Hagë, Holandë.